

AKT-THEMELIM DHE STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR RICA-OIL Sh.p.k.

Neni 1

THEMELIMI I SHOQËRISË

Sot më dt. 20 Gusht 2024, bazuar në kërkesat e Ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), me vullnetin tim të lirë (sot e në vazhdim Ortak Themelues), unë, Vinçens Rica me atesi Vasil, amesi Voisava e datelindjes 08.11.2004, lindur ne Lezhe, dhe banues ne Lac Kurbin Pervizi ndertesa 6 hyrja 1 Lac Sanxhak, me ID personale numer K41108059F dhe leternjoftim elektronik me nr 038128530; vendosa të krijoj Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **RICA-OIL Sh.p.k.** Aktiviteti bazë i kësaj shoqërie rregullohet me anë të këtij Statuti.

Shoqëria vepron në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), me ligjin 9723 datë 03.05.2007, për Qendrën Kombëtare të Biznesit, (të ndryshuar), e të tjera ligje në fuqi të legjislacionit shqipëtar.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku do të shkruhet emëri tregtar dhe nipti.

Neni 2

EMËRTIMI

Emërtimi tregtar është **RICA-OIL Sh.p.k.**

Neni 3

SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën; Lezhe - Zejmen ne zonen kadastrale 3901 me numer pasurie 138/3

Shoqëria **RICA-OIL Sh.p.k.** ka të drejtë të hapë zyra, përfaqësi e filiale në rrethe të tjera të vëndit dhe jashtë Shqiperisë.

Neni 4

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë **RICA-OIL Sh.p.k.** është pa afat.

Afati mund të caktohet ndryshe, apo të vihet në likujdim, vetëm me vëndim të Asamblesë së Përgjithshme te Ortakëve, ose të Ortakut të Vetëm.

Neni 5

PËRGJEGJËSITË

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët ne emërin e tij personal ndaj personave të tretë.

Neni 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar **RICA-OIL Sh.p.k.** është: Import-Eksport, tregtim shitje me pakice karburant te llojit benzine, nafte, gaz, autogaz, lubrifikante, bar-restorant, hotel , lavazh, gomisteri, servis makinash, pjese kembimi,Investitor ne Ndertim, si dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar me ligj.

Neni 7

KAPITALI I SHOQËRISË

Vlera e përgjithshme e kapitalit të rregjistruar si Kapital Themeltar Fillestar i Shoqërisë **RICA-OIL Sh.p.k.** Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 Lekë** (Njeqindmijeleke) . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme: me Ortake Themelues:

1. **Vinçens Rica**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme = 100 000 Lekë ; që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

1. Në rastin e transferimit të kuotave të kapitalit, ortaku që kërkon të shesë kuotat e tij të kapitalit duhet të njoftojë me shkrim administratorin , i cili njofton menjëherë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve për cmimin e shitjes së kuotave nga ortaku që kërkon ti shesë.
2. Cmimi i kuotave, oferte për shitje duhet të vendoset ne baze të vlerës reale të shoqërisë në momentin e dhënies së të drejtës. Ortakët e tjerë mund ti blejnë në raport me kuotat ekzistuese, duke ruajtur të njëjtat raporte me kuotat që posedon sejcili.
3. Në qoftë se brenda 30 ditëve nga komunikimi i ofertës për shitje të kuotave të kapitalit të shoqërisë, asnjëri nga ortakët e shoqërisë nuk shprehet për blerjen e tyre, atëherë, kuotat ofertë shitje, mund ti transferohen cdo personi që kërkon ti blejë.

Neni 9

TRANSFERIMI TEK PJESTARI I FAMILJES

Pjesët e kapitalit janë ligjërisht të transferueshme mes bashkëshortëve, si dhe mes paraardhësve dhe pasardhësve. Transferimi i pjesës së kapitalit mes bashkëshortësh, në rast ndarjeje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

Neni 10

TRANSFERIMI I KAPITALIT NË RRUGË TRASHËGIMIE OSE FALIMENTIMI

1. Në rast se një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave me trashëgimtarët e tij, në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues i të drejtave mbi kuotën e tij. Pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk clirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara, administratori mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotave në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të rregjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
3. Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve deri në momentin e rregjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

FORMA E TRANSFERIMIT TË PJESËVE TË KAPITALIT

1. Kontrata për transferimin e pjesës së kapitalit duhet të jetë në formën e aktit noterial, dhe, në rast se pronari i ri nuk është ortak i shoqërisë, duhet të deklarojë shprehimisht në kontratë se është njohur me Aktin e themelimit të shoqërisë dhe Statutin e shoqërisë dhe se është dakord me to. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
2. Administratori, mund të refuzojë rregjistrimin e kalimit të kuotës në QKB, në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratori, nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota.

3. Nëse administratori, apo administratorët refuzojnë të rregjistrojnë kalimin e kuotës, ata njoftojnë për mospranimin e personit të cilit i kalon kuota, brenda një muaji nga dita në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për rregjistrimin e kalimit të kuotës.

Neni 12

ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të rrisë pa kufi kapitalin shoqërisë, në çdo moment, dhe një ose disa herë, me votim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve votues prezent apo përfaqësues sipas ligjit. Mbas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vendos për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë, që, këto fitime të zmadhojnë kapitalin e rregjistruar, të rrisë rezervat statutore ose të shpërndajë dividend.

Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë, pa mbuluar më parë humbjet e trashëguara në pasqyrat financiare. Në të gjitha rastet ndryshimet në kapital pasqyrohen në pjesët e ortakëve në mënyrë proporcionale që janë deklaruar.

Në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 9901, para se të vendoset shpërndarja e dividendit, administratori lëshon certifikatë të aftësisë paguese. Kjo certifikatë lëshohet, vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe se shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori njofton për rregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 13

KRIJIMI I RREZERVAVE

Mbas miratimit të pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve krijon rrezerva statutore. Rrezerva statutore duhet të jetë për çdo vit jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kur këto rrezerva të kapin shumën e 10% të kapitalit themeltar mund të mos krijojnë më rrezerva.

Neni 14

ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Kapitali themeltar mund të zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
2. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufinj të percaktuar me ligj.
3. Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë përballohet nga secili ortak në mënyrë proporcionale sipas kuotave që zotërojnë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë brenda limiteve të ligjit, qoftë edhe nëpërmjet ortakut të vetëm, apo grupe ortakësh, aktiviteteve të shoqërisë apo aksioneve ose kuotave të shoqërive të tjera në të cilat shoqëria bën pjesë.

VR

4. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit njoftohet për rregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet Administratorit

Neni 15

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Administratori.

Neni 16

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Organi vëndimor i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar **RICA-OIL Sh.p.k.** është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Vëndimet e saj me shumicë pengojnë ortakët që mungojnë apo të papajtueshëm , përvec rasteve të së drejtës së tyre të kundërshtimit të ushtruar në raste, afate apo forma të parashikuara në ligj.

Gjatë kohës që shoqëria do të ketë një ortak të vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të gjitha vëndimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve apo Ortaku i Vetëm rregjistrohen në rregjistrin e vëndimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Asambleja është organi më i lartë vëndimor i shoqërisë i cili , e cila, është përgjegjëse për marrjen e vëndimeve për shoqërinë lidhur me çështjet e aktivitetit të shoqërisë dhe vëndos për:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimin e statutit.
- Emërimin dhe largimin e administratorit
- Emërimin dhe largimin e likujduesve dhe ekspertit kontabël të autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për personat e emëruar likujdatorë, ekspert, përfaqesues në gjykatë etj.
- Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe mënyrën e ndarjes së humbjeve të shoqërisë.
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Riorganizimin dhe Prishjen e shoqërisë.
- Çështje të tjera te parashikuara me ligj, të cilat ky statut i lë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 17

MBLEDHJA E ASAMBLESË DHE VOTIMI

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008, në rastet e parashikuara në statut dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë ose të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlere më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5, të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.
9. Vendimet në mbledhjen e asambleve ose pas konsultimit me shkrim merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se tre të katërtat e kapitalit themeltar. Ky numër votash mjafton edhe për ndryshimin e statutit të shoqërisë.
10. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, rregjistrohen në proces verbal dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e kopjove të tyre.

Neni 18

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

1. Ortaku ka të drejtë të informohet lidhur me administrimin e shoqërisë, të njihen me bilancin vjetor dhe të kërkojë me shkrim sqarime të cilat i jep administratori i mbledhjes së asamblesë.

VB

2. Secili nga ortakët ka të drejte t'i kerkojë gjykatës që të heqë nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.
3. Secili nga ortakët ka të drejte t'i paraqesë me shkrim dy herë në vit administratorit pyetje lidhur me problemet, egzistenca e të cilëve vë në dyshim vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë. Lidhur me përgjigjen e administratorit vihen në dijeni edhe Eksperti Kontabël i Autorizuar.
4. Në rast se shoqëria nuk ka Ekspert Kontabël të Autorizuar, atëherë emërtimi i një eksperti kontabël të autorizuar mund te kërkohet në rrugë gjyqësore nga një ose disa ortakë, pjesët e kapitalit të të cilëve perfaqësojnë të paktën 5% e kapitalit themeltar.
5. Një nga disa ortakë, pjesa e kapitalit të të cilëve së bashku perfaqësojnë 5% e kapitalit themeltar, mund të kerkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një ose disa ekspertëve të ngarkuar për paraqitjen e një raporti për një apo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorëzohet ortakut/ortakëve që ka bërë kërkesën, administratorit, eventualisht ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se janë emëruar, raporti paraqitet në mbledhjen e ardhshme të asamblesë.
6. Ortaku nuk mund të marrë hua nga shoqëria, të mimratojë në emër të shoqërisë paradhëniet ose të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pavlefshëm, kjo vlen edhe për përfaqesuesit ligjorë të tij, bashkëshortin si dhe pasëardhësit e tij.
7. Ortaku që është person juridik, është i detyruar që menjëherë të njoftojë ortakët e tjerë lidhur me ndryshimet e statutit ose të përbërjes së organeve te shoqërise së tij.
8. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
9. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqesues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

NENI 19

ADMINISTRATORI

Shoqëria përfaqësohet nga administratori.

Në emër të shoqërisë firmos administratori i cili bashkëngjit emërtimin tregtar të shoqërisë, emërin e mbiemërin dhe funksionin e tij.

NENI 20

EMËRIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë **RICA-OIL Sh.p.k.** do të jetë një ose më shumë persona që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e zakonshme të votave të ortakëve ose Ortakut të Vetëm. Administratori emërohet për një afat pesë vjecar më të drejte persëritje



Administratori i shoqërisë do të jetë **z. Vinçens Rica** datelindjes 08.11.2004 idendifikuar me kartë identiteti ID personale numer K41108059F, për një afat 5 vjeçar me të drejta perseritje.

Administratori mund të jetë ortak në shoqëri ose jo.

Asambleja e Përgjithshme Ortakëve mund të shkarkojë atë në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 21

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të drejta të veprime në emër të shoqërisë në marrëdhënie me persona të tretë persona i përket të gjitha çështjeve me përjashtim të atyre që ligji ose ky statut i lë në kompetencë të asamblesë.
2. Administratori ka për detyrë në kuadrin e kompetencave të tij të sigurojë mbajtjen e rregullt të evidencës dhe llogarisë sipas ligjit, të mbaje listën e të gjithë ortakëve dhe të informojë ortakët lidhur me çështjet që i takojnë shoqërisë.
3. Përgadit dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe raportet për ecurinë e shoqërisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet para asamblesë së përgjithshme për miratim;
4. Paralajmëron në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë ;
5. Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë , sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
6. Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë.
7. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:
 - Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - Kur kërkohet shitja apo disponimi i aktiveve në një mënyrë tjetër me një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë të vlerësuara në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
8. Administratori ka për detyrë të përcaktojë stafin drejtues dhe të pajtojë punëmarrës në shoqëri në funksionet që ai i sheh të arësyeshme .
9. Nënshkruan kontratat e punës me punëmarrësit.
10. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në këtë statut.

VB

NENI 22

PËRGJEGJËSITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i shoqërisë është përgjegjës individualisht , ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
2. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17,e 18 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar)
3. Administratori nuk mund të marrë hua nga shoqëria, te miratojë në emër të shoqërisë paradhëniet ose të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pavlefshëm, kjo vlen edhe për përfaqësuesit e tij ligjorë, bashkëshortin si edhe paraardhësit apo pasëardhësit e tij.
4. Administratori ka detyrë që të paktën një herë në vit t'i paraqesë asamblesë raportin mbi aktivitetin e shoqërisë dhe gjëndjen e pasurisë së tij.
5. Administratori përgatit dhe i paraqet asamblesë raportin lidhur me marrëveshjen mes atij ose një ortaku dhe shoqërisë. Ortaku që është palë e marrëveshjes nuk mund te votojë në mbledhjen e asamblesë. Administratori ose ortaku që nënshkruajnë një marrëveshje pa miratimin e asamblesë i përgjigjen shoqërisë për dëmin e shkaktuar si pasojë e kësaj marrëveshjeje.
6. Administratori, gjatë kryerjes se detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arësyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

NENI 23

USHTRIMI VJETOR , PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor. Në fund të vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqëruar me një relacion shtesë për aktivitetin e shoqërisë.

NENI 24

NDARJA E FITIMIT

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të ligjit 9901 datë 18.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme të

Ortakëve ose ortaku të vetëm të saj, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat perkatëse të ortakëve.

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% të destinuar për rezervën ligjore, që arrin deri në 10 % të kapitalit të shoqërisë, si edhe reduktimet eventuale të përcaktuara nga Asambleja, shpërndahen ndërmjet ortakëve në raport me kuotat e kapitalit që zotëron secili.

NENI 25

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të dalin gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë si dhe në përgjithësi të gjitha mosmarrëveshjet e ortakëve, apo midis një ortaku dhe shoqërisë, në parim do të zgjidhen me mirëkuptim në bazë të aktit të Akt-themelimit dhe Statutit, në mungesë të mirëkuptimit zgjidhja i besohet Gjykatës Shqipëtare kompetente në Rrethin Gjyqësor përkatës.

NENI 26

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shoqëria shpërbëhet :

- Ditën e shënuar në rregjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Ditën e shënuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për prishjen e shoqërisë.
- Me hapjen e procedurave të falimentimit
- Në raste të tjera të parashikuara në ligj.
- Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohe :
 - kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - me vendim të Asamblese se Ortakëve;
 - me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - me vendim të gjykatës;
 - Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri në likuidim e sipër “.

- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket
- Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 27

GJUHA

Ky statut dhe cdo dokument tjetër zyrtar paraqiten në gjuhën shqipe.

NENI 28

BAZA LIGJORE

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, është kompetencë e Asamblesë së Ortakëve ose Ortakut të vetëm, që të bëjë plotësimin e dispozitave të këtij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave të cilat bëhen të pavlefshme dhe jo efektive.

Ndryshimet do të bëhen me Vendim të Asamblesë Ortakëve, në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit shqipëtar, dhe depozitohen në QKB.

Ortak Themelues:

Vinçens Rica

Vinçens Rica 